



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.,

Shkodër, më _____.____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

[17.09.2026]

Drejtuar: REJ - J93711608Q, Adresa: Tiranë Rruga “Dritan Hoxha”, Ngjitur me Shkollen
“Ahmet Gashi”, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, Hyrja 3, Apartamenti 26, Zona
Kadastrale 8310

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Shërbim**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar**

Numri i Procedurës / **REF-93048-07-09-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, Zona Perendimore** - Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

Fondi limit: 103,862,716 (Njëqind e tre milion e teteqind e gjashtedhjetë e dy mijë e shtateqind e gjashtembedhjetë) leke pa tvsh ose 1,107,278 (një milion e njëqind e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) Euro.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 09.07.2026 është 93.80 Lekë/Euro.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 10.07.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [13.07.2026] [45],

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **x**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik REJ - J93711608Q. Vlera ofertës 91,376,730 (nëntëdhjetë e një milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.**

Vlera OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **x**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

- 2. Bashkimi i operatorëve ekonomik "LEKA - 2007" - K77929501L (36%) dhe ALPEN PULITO - K61516506H (64%). Vlera ofertës ekonomike 89,879,529 (tetëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.**

Vlera OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **x**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

- 2. Operatori ekonomik ALKO IMPEX CONSTRUCTION - K91628013D. Vlera ofertës ekonomike 80,002,932 (tetëdhjetë milion e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.**

Vlera OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **x**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Bashkimi i operatorëve ekonomik **"KARL GEGA KONSTRUKSION"** - **J66703076W & COGREN - J74818825K**. Vlera ofertës ekonomike **90,554,472 (nëntëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.**

Vlera OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori ekonomik **S I L V E R - K88010301S**. Vlera ofertës ekonomike **96,512,430 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.**

Vlera OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik ALKO IMPEX CONSTRUCTION, pasi:

- Mungon Ekstrakti/QKB-ja e operatorit ekonomik ofertues “Alko Impex Construction”.
- Vërtetimi i statusit aktiv është lëshuar më datë 03.09.2026, pra pas datës së hapjes së ofertave, 10.08.2026.
- Vërtetimi i gjendjes gjyqësore është lëshuar më datë 03.09.2026, pra pas datës së hapjes së ofertave, 10.08.2026.
- Mungon vërtetimi i gjendjes gjyqësore për administratorin, z. Arbër Abazi, i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- Vërtetimi i pagesës së sigurimeve shoqërore është lëshuar më datë 03.09.2026, pra pas datës së hapjes së ofertave, 10.08.2026.
- Për subjektin mbështetës “Alko Impex General Construction”, nuk janë paraqitur dokumentet që vërtetojnë mospasjen e shkaqeve të skualifikimit, sipas nenit 90, pika 2 të VKM nr. 285, përfshirë dokumentacionin përkatës, si dëshmia e penalitetit etj.
- Punonjësja Etleva Shabani, e deklaruar si pjesë e stafit, nuk rezulton e punësuar për tre muajt e fundit, pasi nuk figuron në listëpagesën e sigurimeve shoqërore për muajin qershor.
- Punonjësi i deklaruar në pozicionin Shofer, z. Avni Pisha, rezulton i siguruar vetëm për muajin qershor, sipas listëpagesës së sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DST.
- Punonjësi i deklaruar në pozicionin Shofer, z. Përparim Fisniku, nuk disponon leje drejtimi të vlefshme, pasi leja e drejtimit e paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor rezulton e skaduar më datë 20.01.2025.

- Autoboti me targë AB 914 YN, i deklaruar me standard emetimi Euro 5, rezulton në lejen e qarkullimit me standard emetimi Euro 4, në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në DST.
- Për autobotin me targë AB 504 IO, nuk është vërtetuar përmbushja e kriterit të standardit të emetimit të gazrave Euro 5.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik "LEKA - 2007" dhe ALPEN PULITO , pasi:

1-Formulari i sigurimit të ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomike Leka-2007 sh.p.k & Alpen Pulito sh.p.k nuk është sipas shtojcës 3 të DST.

Afati i vlefshmërisë së sigurimit të ofertës sipas DST duhet të jetë 150 ditë kalendarike nga data e hapjes së ofertave që është data 10.08.2026, ndërsa afati i vlefshmërisë në formularin e sigurimit të ofertës së paraqitur është më i vogël se 150 ditë pasi fillon afatet e vlefshmërisë me datë 06.08.2026 pra katër ditë më pak sa afati i përcaktuar në DST.

2-Operatori ekonomik Alpen Pulito sh.p.k nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2025 sic përcaktohet në pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik në DST.

3-Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë: Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: - Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, **dhe elementet që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.**

Ne nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: - - - Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë **duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit**, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Në kontratën e bashkëpunimit midis paleve Leka 2007 sh.p.k& Alpen Pulito sh.p.k me nr. rep:4943, datë 08.08.2026 por edhe në ofertë/preventivin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk janë parashikuar në mënyrë të detajuar elementët konkretë të shërbimit që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë por është përcaktuar vetëm ndarja në përqindje e tyre.

Ndarja e zërave konkretë është një kërkesë e parashikuar në aktin normativ si më sipërcituar dhe është një faktor i rëndësishëm mbi të cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e përmbushjes së secilit kriter të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithnjë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik Leka 2007 sh.p.k & Alpen Pulito sh.p.k, për vërtetimin e krijimit të bashkimit dhe konkretisht kontrata e bashkëpunimit në të cilën nuk është bërë ndarja konkrete e zërave të shërbimit objekt prokurimi, nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, duke bërë të pamundur verifikimin e plotësimit të dokumentacionit të paraqitur nga secili anëtar i këtij bashkimi në përputhje me përqindjen e marrë përsipër.

4-Në DST e publikuara nga AK,pika 2.3.6 e kapacitetit Teknik është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë 34 (tridhjetë e katër) punonjës shërbimi.

Në kontratën e bashkëpunimit midis palëve Leka 2007 sh.p.k & Alpen Pulito sh.p.k me nr. rep:4943 date 08.08.2026 shoqëria Leka 2007 sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 36% të zërave të shërbimit dhe referuar kësaj ndarje në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 10 shoqëria Leka 2007 sh.p.k ka deklaruar se disponon 9 punonjës shërbimi nga 12 që duhej të kishte deklaruar për plotësimin e pikës 2.3.6 të DST sipas përqindjes që ka marrë përsipër të realizojë.

5-Ne DST e publikuara nga AK, pika 2.3.6 e kapacitetit Teknik është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë 7 (shtatë) shofer.

Në kontratën e bashkëpunimit midis palëve Leka 2007 sh.p.k & Alpen Pulito sh.p.k me nr. rep:4943 datë 08.08.2026 shoqëria Alpen Pulito sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 64% të zërave të shërbimit dhe referuar kësaj ndarje në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 shoqëria Alpen Pulito sh.p.k ka deklaruar se disponon 1 shofer nga 5 që duhej të kishte deklaruar për plotësimin e pikës 2.3.6 te DST sipas përqindjes që ka marrë përsipër të realizojë.

6-Ne DST e publikuara nga AK,pika 2.3.7 e kapacitetit Teknik eshte kerkuar nder te tjera që operatori ekonomik te disponoje:

- a) Mjet kompatator, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës minimum 10 ton, minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta **2 (dy) copë;**
- b) **Makinë kompatator (rezerve), me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës minimum 10 ton, minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta 1 (nje) copë**
- c) **Mjet kompatator me kapacitet mbajtës 7-8 ton, minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta 1 (një) cope.**

Në kontratën e bashkëpunimit midis palëve Leka 2007 sh.p.k & Alpen Pulito sh.p.k me nr. rep:4943 datë 08.08.2026 shoqëria Alpen Pulito sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 64% të zërave të shërbimit dhe referuar kesaj ndarje ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 10, shoqëria Alpen Pulito sh.p.k nuk ka deklaruar asnjë mjet teknologjike për realizimin e shërbimit të pastrimit nga 4 që duhej teë kishte deklaruar për plotësimin e pikës 2.3.7 te DST sipas perqindjes qe ka marrë përsipër të realizojë. Mjeti i vetëm që OE Alpen Pulito sh.p.k është pika e) *makinë transporti me kapacitet deri në 3.5 ton minimalisht Euro 5 ose standard më të larta 1 (një) copë.*

7-Ne DST e publikuara nga AK,pika 2.3.5 e kapacitetit Teknik është kërkuar:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar staf teknik për te pakten **3 (tre) muajt** e fundit si me poshte:

1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert ne fushen e Mjedisit)

Shoqeria Leka 2007 sh.p.k. ne formularin permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 10 nuk ka deklaruar se disponon stafin e mesiperm ne kundershtim me Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar , pika 3 ku parashikohet shprehimisht se: - - Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me

përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomik "KARL GEGA KONSTRUKSION" - & COGREN pasi:

1-Ne DST e publikuara nga AK,pika 2.3.6 e kapacitetit Teknik eshte kerkuar qe operatori ekonomik te disponoje 7 (shtatë) shofer.

Ne kontraten e bashkepunimit midis paleve Karl Gega Konstruktion sh.p.k & COGREN sh.p.k me Nr.33 prot date 08.08.2026 shoqeria Karl Gega Konstruktion sh.p.k ka marre persiper te realizoje 30% te zerave te sherbimit dhe referuar kesaj ndarje dhe zerave konkrete te preventivit te realizimit te sherbimit ne formularin permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 10 shoqeria Karl Gega Konstruktion sh.p.k ka deklaruar se disponon 1 shofer nga 2 qe duhej te kishte deklaruar per plotesimin e pikes 2.3.6 te DST sipas perqindjes qe ka marre persiper te realizoje.

$7 \times 30\% = 2.1$ duke mospermblusur ne kete menyre nr e shofereve qe duhej te kishte ne dispozicion sipas aktmarreveshjes.

2-Ne DST e publikuara nga AK,pika 2.3.6 e kapacitetit Teknik eshte kerkuar qe operatori ekonomik te disponoje 34 (tridhjetë e katër) punonjes sherbimi

Ne kontraten e bashkepunimit midis paleve Karl Gega Konstruktion sh.p.k & COGREN sh.p.k me Nr.33 prot date 08.08.2026 shoqeria Karl Gega Konstruktion sh.p.k ka marre persiper te realizoje 30% te zerave te sherbimit dhe referuar kesaj ndarje dhe zerave konkrete te preventivit te realizimit te sherbimit ne formularin permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 10 shoqeria Karl Gega Konstruktion sh.p.k ka deklaruar se disponon 9 punonjes sherbimi nga 10 qe duhej te kishte deklaruar per plotesimin e pikes 2.3.6 te DST sipas perqindjes qe ka marre persiper te realizoje duke mospermblusur ne kete menyre nr e punonjesve te sherbimit qe duhej te kishte ne dispozicion sipas aktmarreveshjes.Ne kete deklarim nuk jane marre parasysh si punonjes sherbimi administratorët ligjore te shoqerise si dhe stafi Drejtues Teknik inxhinier.

3-Ne DST e publikuara nga AK,pika 2.3.7 e kapacitetit Teknik eshte kerkuar qe operatori ekonomik te disponoje:

- a) Mjet kompatator, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës minimum 10 ton, minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta **2 (dy) copë;**
- b) Makinë kompatator (**rezerve**), me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës minimum 10 ton, minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta **1 (një) copë**
- c) Mjet kompatator me kapacitet mbajtës 7-8 ton, minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta **1 (një) cope.**
- d) Makinë (autobot) me kapacitet mbajtës uji jo më pak se 2000 litra i pajisur gjithashtu me pompë dhe pistoletë uji për larjen me presion dhe dezinfektimin e konteinereve minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta jo më pak se **1 (një) copë;**
- e) Makine transporti me kapacitet deri ne (3,5) ton minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta **1(nje) cope**

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën **2.3.7**, gërma (a – f) , operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (original ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me **tipin e mjetit të porositur(emertimin teknik), llojin, marken, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë**. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.
- Per mjetet e paregjistruara ne Republiken e Shqiperise, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerje **sipas njerit prej rasteve ne vijim**,
 - (i) me pronarin e automjeteve.
 - (ii) me koncesionarin ose ndermjetesin ne rastin kur ka periudhe tranzitore per te pasur te drejten e posedimit te mjeteve.
 - (iii) meprodhuesin ose koncesionarin ne rastin e paraqitjes ne proceduren e prokurimit me mjete te reja.

Ne te gjitha rastet subjekti duhet te paraqese dokumentacionin e nevojshem i cili verteton se subjekti që merr përsipër furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit te vendit të origjinës, të drejten për të pasur në pronësi ose gëzuar të drejtën e shitblerjes se mjeteve te paraqitura.

Për plotësimin e pikës 2.3.7 të DST për disponimin e makinerive keni paraqitur aktmarrëveshjen Nr. repertori:2257 datë 07.08.2026 me subjektin Anuar sh.p.k , subjekt shqiptar që vepron në fushën e tregtisë së automjeteve dhe mjetet e paraqitura në katalogun bashkëlidhur kontrats së porosisë janë në pronësi të subjektit CLEANMAT TRUCKS që është një subjekt i huaj.

Ju nuk keni paraqitur asnjë dokumentacionin të nevojshëm i cili verteton se subjekti që merr përsipër furnizimin e mjeteve, ka sipas dokumentacionit te vendit të origjinës të drejten për të pasur në pronësi ose gëzuar të drejtën e shitblerjes se mjeteve te paraqitura ne kundershtim me kriterin e percaktuar ne DST.

Subjektin Anuar sh.p.k nuk ka paraqitur asnje dokument/akmarreveshje/kontrate etj., që vërteton lidhjen me subjektin CLEANMAT TRUCKS që është pronari/disributori i mjeteve të porositura duke mos garantuar autoritetin kontraktor që mjetet e paraqitura në katalog janë mjetet që propozohen për realizimin e shërbimit të pastrimit.

4. Operatori ekonomik S I L V E R, pasi:

2.3.1 Operatori nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme me vlerën minimale 41,545,086 lekë pa TVSH. Përveç kontratës së shërbimit të realizuar me Bashkinë Vlorë për periudhën 03.07.2023-02.07.2024, për të cilën operatori ka dorëzuar formularin e vlerësimit për përmbushjen me sukses të shërbimit, dhe faturave të sjella me subjektin “Profarma” për shërbimin “Evadim mbetjesh urbane”, faturat e tjera nuk përkojnë me objektin e procedurës qe tenderohet.

2.3.7 Pika d) e këtij kriteri kërkon: Makinë (autobot) me kapacitet mbajtës uji jo më pak se 2000 litra i pajisur gjithashtu me pompë dhe pistoletë uji për larjen me presion dhe dezinfektimin e konteinereve minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta jo më pak se 1 (një) copë. Për pikën d) të këtij kriteri, operatori deklaroi 3 (tre) mjete nga 1 (një) që kërkohet. Për dy prej tyre deklaroi se mjetet e përmbushin standardin Euro 5, kur në të vërtetë vitet e

prodhimit janë 2003 (AA978TH) dhe 2007 (AA941NL). Mjetin tjetër, edhe pse nuk e deklaroi si standard Euro 5 me vit prodhimi 1998 (AA846NX), e ka përfshirë tek lista e mjeteve që ofron. Pika e) e këtij kriteri kërkon: Makine transporti me kapacitet deri në (3,5) ton minimalisht Euro 5 ose standarde më të larta 1 (një) cope. Për pikën e) të këtij kriteri, operatori deklaroi 2 (dy) mjete, nga 1 (një) që kërkohet. Të dy mjetet AB110EZ (2005) dhe AA271XD (1991) nuk e përmbushin standardin Euro 5 ose më lart.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: operatorin ekonomik **REJ sh.p.k me NIPT J93711608Q** përfaqësuar nga administratori z. Luan Kapri me Adresë: Tiranë Rruga Dritan Hoxha, Ngjitur me Shkollën Ahmet Gashi, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, Hyrja 3, Apartamenti 26, Zona Kadastrale 8310 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **91,376,730 (nëntëdhjetë e një milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH** është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

**KRYETAR
BENET BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR**

ALBAN PREKA